



SHOQATA E NDERTUESVE TE SHQIPERISE
ALBANIAN CONSTRUCTORS ASSOCIATION

Miratuar me Vendim Nr. 38 date 12.10.2001 te Gjykates se Tiranes
Llogaria bankare, Banka Kombetare Tregetare, Dega 2, Tirane, Nr. 402002214
Banka Popullore, Nr. 00001179

Nr.3410 Prot.
06.01.2022

Tiranë, më

Drejtuar: : Z.Bledar ÇUÇI
Ministër i Brendshëm

Për dijeni: Z. Edi RAMA
Kryeministër i Shqipërisë

Z. Erion VELIAJ
Kryetar I Bashkisë Tiranës

Z. Gledis NANO
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Z. Lorenc PANGANIKA
Drejtor i Policisë së Tiranës

Z. Besmir QIBINI
Drejtor i Policisë Rrugore të Tiranës

Lënda: Kërkesë për lejimin i lëvizjes së mjeteve të përpunimit dhe transportit të betonit, gjatë orarit të punës në Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Shoqata e Ndërtuesve dhe Prodhuesit e Betonit, Ju urojnë një vit të mbarë, plot shëndet dhe suksese. Në aktivitetin Tuaj.

Shoqata jonë ka qenë partnere dhe dëshiron të çojë përpara këtë partneritet me qeverisjen qendrore dhe lokale në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve që prekin kryesisht sektorin e ndërtimit.

Po ju drejtohem, Juve, si titullari më i lartë i këtij institucioni për zgjidhjen e një problem aktual dhe shumë të rëndësishëm për ne :

Lejimin e vazhdimësisë normale të punës për prodhimin dhe transportin e betonit, lejimin e lëvizjes së autobetonierave të sektorit të ndërtimit gjatë orarit të punës në Tiranë. (Punonjësit e Policisë Rrugore nuk po lejojnë lëvizjen e autobetonierave para orës 20.00 në qytetin e Tiranës)

Theksojmë që ky ka qenë problem i përsëritur ndër vite për ne.

Duhet të sqarojmë se, për specifikat e betonit dhe rrezikshmërinë e lartë që paraqet ky lloj procesi, është e pamundur që të punohet natën në lartësi të mëdha dhe pa ndriçim normal. Gjithashtu, ekzistojnë edhe procese pune që detyrimisht duhet të vazhdojnë pa ndërprerje 12 (dymbëdhjetë) orë e më tepër. Lënia në gjysëm e një bazamenti, strukturave mbajtëse ose e soletave është teknikisht e ndaluar mbasi demton qëndrueshmërinë e objektit.

Gjithashtu, betoni nuk është material i cili shkarkohet si inertet dhe përpunohet në një moment të dytë. Betoni transportohet me makineri të cilësuar si makina teknologjike (autobetoniere), ka një orar teknikisht të caktuar brenda të cilit duhet të jetë i hedhur në vepër.

Për këtë arsye, kërkojmë nga institucionet kompetente lejimin e vazhdimësisë të punës tone normale, duke shmangur kështu, “abuzimet” e punonjësve të policisë ndaj firmave të betonit, në mënyrë të përditshme, në çdo rrugë të Tiranës.

Shpresojmë tek Ju, në zgjidhjen e këtij problemi.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

Me respekt,

Arben DERVISHAJ

Sekretar i Përgjithshëm i SH.N.SH-së